

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Best_oil _2023 SHPK

Me date 26.01.2023 midis personave

1- Marjo Salça shtetas shqiptar, lindur ne 18.11.1992 dhe banues ne Kuçovë , Lagjja 11 Janari", rruga Koço Koleci zona kadastrale 2310, godinë 2- katëshe person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.BF1686649 dhe numer personal J21118057N.

2- Znj.Donald Përcakaj shtetas shqiptar, lindur ne 26.08.1993 në Kuçove dhe banues ne Kuçove " Lagjja 11 Janari" , rruga Skrapar, zona kadastrale 2310, godinë nje katëshe, person madhor me zotësi juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numër personal NR.034864929 dhe numer personal J30826073J.Pronare te pjeseve te kapitalit themeltar siç tregohet me poshte dhe atyre qe mund te behen me pas pronare te pjeseve te kapitalit themeltar eshte hartuar statuti i shoqerise tregtare me emrat e meposhtem.

KAPITULLI I

EMERTIMI, OBJEKTI,SELIA. KOHEZGJATJA

Neni 1

Forma

1-Shoqeria tregtare Best_oil 2023(me poshte shenuar shoqeria) krijohet ne formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar.Veprimtaria e saj rregullohet nga ky statut dhe legjislacioni ne fuqi.

2-Statuti eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar, dhe çdo çështje e parashikuar shprehimisht ne te,rregullohet sipas legjislacionit, Shqiptar ne fuqi.

Neni 2

Emertimi

1.Shoqeria Best_ oil 2023 Sh.p.k.Emertimi i shoqerise, mund të shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

2.Te gjitha shkresat, formularet e urdherave apo çdo dokument tjeter korespondence, nxjerre nga shoqeria, deget apo zyrat e perfaqesimit, nepermjet perdorimit te letres, apo mjeteve elektronike, te cilat u drejtohen paleve te treta, duhet te permbajne te dhenat e meposhtme:

a. Numrin unik te identifikimit

b. Formen ligjore te shoqerise Sh.p.k:

c Vendndodhjen e selise se regjistruar dhe te zyres qendrore te saj

d. Te dhena nese shoqeria eshte ne likujdim

e. Vlera e kapitalit te regjistruar te shoqerise dhe vlera e pjeses se paguar te kapitalit.

Neni 3

Selia

1-Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Lagja " Tafil Skëndo , rruga Koço Koleci, zona Kadastrale 2310, pasuria nr.5/539, godinë 1- katëshe. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti, dhe legjislativës në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri dhe jashtë saj, qendra përfaqësimi, filiale, dege dhe shoqëri të tjera.

Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të përcaktohet një afat kohezgjatje, i cili mund të ndryshohet një ose me shumë here, serish me një vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Tregtim i karburantit lubrifikant të gjitha llojeve për automjete.
- Tregtim i lëndëve djegëse, dru zjarri etj.
- Tregtim i pjesëve të këmbimit për mjetet.
- Import eksport mjete motorike, pjesë këmbimi, shitblerja e tyre.
- Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislativës në fuqi.
- Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj
- Tabachino, pije freskuese, etj.

Neni 6

Përgjegjësia

1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.

Kapitulli II

KAPITALI I REGJISTRUAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

NENI 7

Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (nëqind mijë) leke .

2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) kuota kapitali i ndarë në:

> Marjo Salça 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetë mijë) leke.

>Donald Përcakaj 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (Pesedhjete mije) leke.

Neni 8

Kontributet dhe kuotat e kapitalit themeltar

.1-Derdhja e kapitalit themeltar eshte bere ne masen dhe menyren e meposhtme:

a.Z.Marjo Salça ka kontribuar ne para ne shumen 50.000(Pesedhjete mije) leke.

b.Z.Donald Përcakaj ka kontribuar ne para ne shumen 50.000 (Pesedhjete mije).leke

2.Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre si me poshte:a.Marjo Salça eshte zoterues i nje kuote kapitali me vlere te pergjithshme 50.000 (Pesedhjete mije) leke ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

b.Z.Donald Përcakaj eshte zoterues i nje kuote kapitali me vlere te pergjithshme 50.000 (Pesedhjete mije)leke ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 9

Zmadhimi i kapitalit te regjistruar.

1.Kapitali i regjistruar mund te rritet pa kufinj ne çfaredo momenti, nje ose me shumë here me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

2.Ne rast rritjeje te kapitalit te regjistruar te gjithe ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me kuotat e kapitalit te zoteruar.

3. Ne rast se ata nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere propocionalisht me pjese marrjen respektive.dhe ne rast mungese te nenshkrimit mund te nenshkruhen nga te tretet me miratim te ortakeve.

NENI 10

Zvogelimi i Kapitalit te Regjistruar

1.Me ane te nje vendimi te asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e regjistruar.Ne te gjitha rastet kapitali i regjistruar nuk mund te reduktohet ne kufinjte e parashikuar nga ligji.

2.Me vendim te asamblese te pergjithshme te ortakeve dhe miratimin e ortakut/eve perkates, shoqeria ka te drejten e anulimit dhe likujdimit te kuotave te kapitalit.Me anulimin e tyre, te drejtat e detyrimet qe i rrjedhin ortakut nga zoterimi i kuotes shuhen.

NENI 11

Kuotat dhe kalimi i kuotave te kapitalit

1.Zoterimi i kuotave, menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave, pjesetimi dhe transferimi i tyre do te behen sipas procedurave te parashikuara ne ligjin 9901 date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar dhe nga percaktimet e ketij neni ne vijim.

2. Kuotat e kapitalit mund tu transferohen te tretteve ose ortakeve teresisht ose pjesisht, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

3. Ortaku qe kerkon te transferoje kuotat e tij duhet te njoftoje per projektin e tij, si administratorin ashtu dhe secilin ortak. Njoftimi duhet te behet me leter rekomande me kthim pergjigje per marrjen e njoftimit. Mbledhja e asamblese per miratimin ose refuzimin e projektit te transferimit duhet te behet brenda tre muajve, nga data e njoftimit.

4. Vendimi i ortakeve i njoftohet transferuesit me leter rekomande me kerkese per marrje lajmerimi per marrjen e vendimit. Ne rast se shoqeria nuk ka vendosur brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi konsiderohet i dhene.

5. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, ortaket duhet te blejne ose te lejojne blerjen e kuotave nga data e ketij refuzimi, ortaket duhet te blejne ose te lejojne blerjen e kuotave te kapitalit me vleresimin e te drejtave me ekspert vleresues te caktuar nga palet, ose kur ato nuk merren vesh ndermjet tyre, me ekspert te caktuar nga Gjykata.

6. Kontrata e kalimit te kuotes hartohet ne forme shkresore dhe sipas modaliteteve te percaktuara nga administratoret. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.

7. Ortaket mund te vendosin qe blerja e kuotave te kryhet nga vete shoqeria duke zvogeluar kapitalin themeltar te shoqerise.

8. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimni ose brenda familjes, behet me miratim te ortakeve me kushte jo me pak te favorshme se ato te caktuara nga te trettet.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA. ADMINISTRIMI, KONTROLLI

NENI 12

Asambleja e pergjithshme e ortakeve

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise:

b. Ndryshimet e statutit

c. Emerimin e shkarkimin e administratoreve

d. Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te regjistruar;

e. Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkonjen c dhe d te kesaj pike:

f. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise .

g. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

h. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit:

F ne rastet e parashikuara ne pikat c dhe e te ketij neni, Asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje Ekspert Kontabel i Regjistruar i pavarur.

G .Dispozitat e pikes f te ketij neni nuk zbatohet nese blerjet, sipas pikave d dhe e te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu.Gjithashtu keto dispozita nuk zbatohen ne rastin kur shoqeria zoterohet, nga nje Ortak i vetem.

H ne rastet e parashikuara ne pikat c deri ne e te ketij neni, Asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

NENI 14

Menyra e thirjes se asamblese se pergjithshme

- 1.Asambleja e pergjithshme thiret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjitheve ortakeve, jo me vonë se 7 dite te plotë perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.
- 2.Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirur sipas paragrafit te pare te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort per te marre vendime pavaresisht parregullise.
- 3.Ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, mund ti drejtojne administratoreve nje kerkese me shkrim, perfshire posten elektronike, per te thirur Asamblene e Pergjithshme dhe/ ose perfshirjen e çështjeve te posaçme ne rendin e dites.Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe çështjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim.Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte ta therasin asamblene dhe te caktojne çështjet e rendit te dites, ne perputhje me paragrafin e pare te ketij neni.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk thirret, ose çështja e kerkuar prej saj nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, ka te drejte te ndjeke rruget ligjore te percaktuara ne nenin 84 te ligjit 9901 date 14.04.2008 Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

NENI 15

Perfaqesimi ne Asamble, kourumi, marrja e vendimeve

- 1.Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e Pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë.Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve, ne asamblene e pergjithshme.Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
- 2.V endimet e asamblese se pergjithshme ndahen ne vendime qe kerkojne nje shumice të zakonshme dhe ne vendime te cilat kerkojne shumice te kualifikuar.Vendimet qe kerkojne shumice te kualifikuar jane vendimet: per ndryshimet e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- 3.Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çështje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne

I .Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre:

J.Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjere ndaj administratoreve:

K. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise"

L .Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese:

M.Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtjet te percaktuara ne shkronjat g dhe h te paragrafit te mesiperm, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentave perkates.

3.Nese asambleja zoterohet nga nje ortak, te drejtat dhe detyrimet e asamblese te pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetem.Te gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhena e te cilit nuk mund te ndryshohen apo fshihen.Duhet regjistruar ne veçanti, po pa u kufizuar vetem ne to, vendimet për:

a.Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

:b-Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve:

c Investime

d.Vendimet per riorganizimindhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e marra nga Ortaku i vetem dhe te pa regjistruara ne regjistrin e vendimeve jane te pavlefshme.

Neni 13

Thirrja e Asamblese se pergjithshme

a.Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji 9901 date 14.04.2008" Per tregtatet dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar nga ligje te tjera, nga dispozitat e statutit dhe sa here, qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.**Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.**

b.Asambleja e pergjithshme thiret nga administratori/et apo nga ortakut e pakices siç eshte e përcaktuar ne nenin 84 te ligjit—9901 date 14.04.2008 " Për tregtatet dhe shoqerite tregtare i ndryshuar.

c.Asambleja e Pergjithshme thirret nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

d.Asambleja e pergjithshme kur shoqeria propozon te shese apo te disponije ne menyren tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

e.Asambleja e pergjithshme thiret kur shoqeria,brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve te ketij statuti.

4.Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mbliidhet per shkak te mungeses se kourumit te permendur me siper, asambleja mbliidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

5.Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemmares, per çeshtjet qe kerkojne shumice te kualifikuar si" **per ndryshimine statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.**

6.Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligjin 9901 date 14.04,2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtjet e tjera te zakonshme, me shumicen e votane te ortakeve pjesemarrres.

7.Me perjashtim te rasteve kur parshikohet ndryshe ne ligjin 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar, vendimet qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, kushtezohen nga miratimi i ortakut perkates.

NENI 16

E drejta e pjesëmarrjes dhe e votimit

1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e vet dhe te marre pjese nepermjet votes se tij ne vendime.Çdo ortak ka te drejte vote ne perpjestim me vleren minimale te kuotes se tij.

2.Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nje person i tretë.Autorizimi jepet ne forme shkresore vetem per nje mbledhje te asamblese se Pergjithshme dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhjet vijuese me te njejtin rend.Kur ortak u perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si ortak u perfaqeson.

3.Nje ortak nuk mund te delegoje te drejten per te votuar, ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar personalisht per pjesen tjeter te kapitalit themeltar.

4.Ortaket, qe nuk jane te pranishem, mund te sigurojne mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve,dhe te plotesohen kerkesat e ligjit 9901 date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar.

5.Ortaket kane te drejte, per te marre unanimisht çdo vendim, me kusht qe kjo marreveshje te behet me shkrim.

6.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e Pergjithshme merr vendimin per vleresimine veprimtarise se tij: shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga shoqeria, dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Neni 17

Proçes verbalet e mbledhjeve te asamblese

1. Te gjitha vendimet e asamblese se Pergjithshme duhet te regjistrohen ne proces-verbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te proces verbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme, procesverbali duhet te permbaje daten dhe vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te proces verbalit, rezultatet e votimit. Proçesverbalit i bashkelidhet dhe lista e pjesemarresve, si dhe akti i thirrjes se Asamblese se Pergjithshme. Proçesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

NENI 18

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e pergjithshme mund te vendose nisjen e nje hetimit te posaçem, per paregullsite pergjate ushtrimit te veprimtarise tregtare ne perputhje me kerkesat e ligjit " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare " i ndryshuar per hetimet e posaçme .

NENI 19

Administratoret, emerimi, shkarkimi

1. Shoqeria administrohet nga nje ose disa administratore persona fizike, qofshin keta dhe jo ortake, te cilet emertohen ose shkarkohen nga shkarkohen nga asambleja e Pergjithshme .Administratoret qendrojne ne postin e tyre per pese vjet financiare, me mundesine per tu rizgjedhur.

2. Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve, kontradiktore

Me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

3. Administratori i shoqerise eshte zt. Marjo Salça, lindur ne Kuçove, ne 18.11.1992, dhe banues ne Kuçove mbajtes i leternjoftimit me Nr. BF1686649, dhe me Nr. personal J21118057N. Mandati i administratorit eshte me nje afat pesë vjeçar me te drejtën per tu rizgjedhur.

NENI 20

Kompetencat e administratorit/eve

1-Administratoret kanë te drejte e detyrohen te:

a. Kryejne te gjitha veprimet e administratorit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme:

b. Perfaqesojne shoqerine tregtare:

c. Kujdesen per mbajtjen e sakte te rregullt te dokumentave, dhe te librave kontabel te shoqerise:

ç. Pergatisin dhe nenshkruajne Bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqisin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim:

d. Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise:

dh.Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit:

e. Raportojne perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare:

ë.Kryejne detyra te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

2.Administratoret jane te deryruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

> Sipas Bilancit Vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise, nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda tre muajve ne vazhdim.

>Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive. Te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

>Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

3.Nese asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

4.Administratoret kane te gjitha te drejtat per te vepruar ne marredhenie me te tretët, ne interes te shoqerisë dhe ne emer te saj, ne te gjitha rrethanat qe kane lidhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te kompetencave, qe ligji apo statuti ia jep Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

NENI21

Pergjegjesite e Administratorit

1.Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te tretëve, per shkelje te ligjeve te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

2.Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja e Pergjithshme qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

3.Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14.15.17 te ligjit 9901 adte 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, Administratori detyrohet:

a.Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis:

b.Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita:

c. Te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet per te cilat merret vendim:.

d.Te parandaloje dhe te menjanoje, rastet e konfliktit prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise:

e.Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

4. Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mos veprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

5. Nese Administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 3 dhe 4 te ketij neni, eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

6. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, Administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, kryen veprimet e meposhtme:

a. U kthen ortakeve kontributet:

b. U paguan ortakeve interesa apo dividente

c. U shperndan aktivet shoqerise:

d. Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet:

e. Jep kredi.

7. Ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese se Pergjithshme te Ortakeve nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder Administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

NENI 22

Skualifikimi dhe largimi i Administratoreve

1. Detyra e Administratorit perfundom ne rast se:

a. Personi pushon se qeni Administrator ne baze te dispozitave te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 " Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar duke perfshire parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te ketij ligji.

b. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese

c. personi vuan ose mund te vuaj per çregullime mendore

d. Personi jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose

e. Ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi palejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe asambleja e pergjithshme me propozim te administratoreve vendos ta shkarkoje nga detyra.

NENI 23

Ekspertet kontabel



1. Shoqeria do te kontrollohet nga nje ose me shume Auditues Ligjor (Eksperte Kontabel) te zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, te emeruar nga Asambleja e Pergjithshme, sipas kerkesave dhe rregullave te legjislacionit per auditin e pavarur.

Kapitulli IV

VITI FINANCIAR BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE.

Neni 24

Viti financiar dhe pasqyrat financiare

1. Viti financiar fillon me 01 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor.

Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar, prane qendres kombetare te regjistrimit dhe perfundon ne 31 dhjetor te te njejt vit.

2. Pasqyrat financiare, raporti i administrimit dhe Ekspertit/ve Kontabel te regjistruar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e ortakeve sipas kushteve te parashikuara ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar dhe statute.

Neni 25

Marredheniet ndermjet shoqerise dhe ortakeve

1. Pas miratimit te pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise, ortaket kane te drejte te percaktojne destinacionin e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare. Fitimi i deklaruar, mund te destinohet per rritjen e kapitalit te rregjistruar, shperndarje ne forme dividendesh, fitim te pacaktuar apo ndonje rezerve tjeter qe vendos asambleja. Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.
2. Shoqeria mund tu shperndaje fitime ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit, aktivet e shoqerise, mbulojne teresisht detyrimet e saj dhe shoqeria ka aktive likuide te mjaftushme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim, bazuar ne nje certifikat te aftesise paguese leshuar nga administratori. Keto kerkesa, zbatohen gjithashtu ne rastet kur pavaresisht nga dhenia e miratimeve te nevojshme, shoqeria do te kryej nje pagese ne favor te nje prej ortakeve te saj, ne baze te nje marreveshje te lidhur mes shoqerise dhe ortakut, e cila perman kushte me pak te favorshme per shoqerine ne krahasim me kushtet normale te tregut.
3. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese qe duhet te leshohet sipas ketij neni.

KAPITULLI V

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

NENI 26

Prishja likujdimi



1. Perjashtuar rastet e nje prishjeje te parashikuar nga ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar, shoqeria mund te prishet ne çdo kohe, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve.
2. Pervec rastit te bashkimit ose ndarjes, prishja e shoqerise per çfaredo shkak qofte sjell likuidimin e asj. Likuidimi kryhet nga nje ose disa likujdues te emeruar nga Asambleja, te cilet kryejne kete detyre ne perputhje ne statutin e shoqerise, ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar dhe kerkesat e tjera ligjore.
3. Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.
4. Likujduesi perfaqeson shoqerine. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te pa arketuara dhe te kontributeve te pa shlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar rradhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil. Shperblimin e likujduesit/ve se bashku me rimbursimin e shpenzimeve dhe aktivet e mbetura u shperndahen ortakeve ne perpjestim me kuotat ne kapitalin e regjistruar.
5. Me perfundimin e proçedures se likujdimit te shoqerise. Asambleja do te vendose mbi bilancin fianciar perfundimtar, mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likujduesit dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit
6. Shoqeria mund te likuidohet nepermjet nje proçedure te pershpejtuar nese kjo vendoset nga te gjithet ortaket e saj dhe kur keta deklarojne perpara gjykates perkatese, se te gjitha detyrimet e Shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer dhe jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemerresit
7. Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me ligjin " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

KAPITULLI VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 27

Riorganizimi i shoqerise

1. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve shoqeria, mund te organizohet nepermjet bashkimit me nje shoqeri tjeter, nepermjet ndarjes ne dy apo me shume shoqeri te tjera ose nepermjet shnderrimit te formes ligjore, ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar dhe dispozitave te tjera ligjore.

NENI 28

Kundershtimet

1. Te gjitha kundershtimet ose mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj, midis ortakeve, ose nje apo me shume prej tyre dhe shoqerise, do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejt, midis te interesuarve per ti zgjidhur miqesisht. Ne rast te kundert i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

NENI 29

Baza ligjore

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Per sa nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar, Kodi Civil, legjislacioni tregtar dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperisë.

NENI 30

1. Statuti i shoqerise pasi u lexua nga ortaket e shoqerise u nenshkrua prej tyre pa verejtje.

Ky statut eshte pergatitur ne kater kopje te barasvlefshme ne gjuhen shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE Best_oil 2023 SH.P.K

DONALD PËRCAKAJ



MARIO SALÇA

